

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BIRN - Rama injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918724/rama-injoron-konsultimet-publike-fut-ne-shqyrtim-re-formen-territoriale/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:05:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 17:04:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ee23959d70c15833a49cf464636463c288df0baa5b719a1ce6d8934a8dc416ae
TEKSTI	c8b2c38057ddb372656231a9157b81fac6060152042d507f2cdccc042d2aa835
PAMJA	eb9ff3b4dfab0ccb792fd6ab5f498aa6a5798a44dc87a040d5f1d99ed987ed11

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ce9820a49423c008e738b2d0e6f5ab0cba19f38bf2467156bfb52c9b31cfd4a5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ce9820a49423c008e738b2d0e6f5ab0cba19f38bf2467156bfb52c9b31cfd4a5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës

LAJMI I FUNDIT

LIVE-Protesta e 116-të/ Shqiptarët në revoltë kundër qeverisë: Rama jep dorëheqjen**më të lexuarat**VIDEO-'Janë 3 orë përgjime'/ Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...Ura shembet 1 javë pas inaugurimit/
Vata: 40 mln lekë nga paratë e qytetarëve
të hedhura në lumëProtesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vijnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me LushnjënProtesta e 114/ Mbyllen fjalimet para
Kryeministritë, qytetarët nisin
marshimin: Rama jepe dorëheqjen'Rusia synon përçarjen'/ Burimi: Sulmet
hibride për të sjellë në pushtet forcat që
nuk ndihmojnë UkrainënVIDEO-'Hajde të tregoj unë ty'/
Përplasja me Ramën në avion, i ri: Më

Rama injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale

19:04, 23/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Komisioni për Çështjet Ligjore mori në shqyrtim të mërkurën projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore" të propozuar nga deputetët socialistë, ndërsa konsultimet publike me komunitetet lokale vijojnë deri në fund të shtatorit.

Ulsi Manja, kryetar i këtij komisioni, refuzoi të hidhte në votim kërkesën e opozitës për të rikthyer procedurën e shqyrtimit dhe depozitimin e nismës me përfshirjen e qëndrimeve që vijnë nga komunitetet lokale.

"Ne do të vijojmë shqyrtimin në parim deri më 29 shtator, kur është afati i përfundimit të konsultimeve nëpër bashki, pastaj pasi të marrim dhe këto qëndrime, e votojmë," tha ai.

Sipas një kalendari pune të Kuvendit, ku parashikohet votimi në seancë plenare më 8 tetor, socialistët në mënyrë të njëanshme kanë vendosur të avancojnë përpara procedurën parlamentare të nismës, ku propozohet një rikonfigurim i hartës territoriale të vendit me reduktimin e bashkive nga 61 në 46.

Opozita kundërshtoi në komision futjen në rend dite të nismës së PS-së, duke pretenduar se nisma ishte dorëzuar në shkelje të dispozitave ligjore dhe kushtetuese duke anashkaluar përfundimin e konsultimeve publike.

"Të kthehet pas dhe të futet në procedurën kushtetuese se s'mund të ecim në shkelje të Kushtetutës," tha Luçiano Boçi, i cili ishte bashkëkryetar i opozitës për komisionin bipartizan për këtë reformë.

"Të mbarojnë dëgjesat, të merret mendimi dhe më pas të vihet këtu," shtoi ai, duke këmbënaulur se një reformë e njëanshme pa konsensus politik dhe për më

tepër pa konsensus qytetar bie ndesh me parashikimet kushtetuese.

Edhe deputeti Oerd Bylykbashi kërkoi që Komisioni i Ligjeve të votonte për kthimin e projektligjit në zyrën e Kryetarit të Kuvendit për t'u përfshirë në nismë edhe qëndrimet e konsultimeve publike.

"Kjo nismë godet themelet e Kushtetutës dhe është detyrim ligjor që të merren parasysh qëndrimi i popullsisë," tha Bylykbashi, duke akuzuar mazhorancën se ka nisur procedurën në shkelje ligjore dhe se po tenton të anashkalojë qëndrimet e komuniteteve.

Deputetë të tjerë të PD-së sollën në vëmendje që në bashkitë që projekti i PS-së parashikon t'i shkrijë me bashki më të mëdha po bëhen protesta të përditshme kundër nismës dhe vetë këshillat bashkiakë kanë votuar kundër shkrirjes.

Në shenjë revolte, deputetët e opozitës braktisën mbledhjen e komisionit, e cila vijoi me prezantimin e nismës nga Arbjan Mazniku.

Mazniku tha se reduktimi i numrit të bashkive do të siguronte më shumë shërbime për qytetarët.

Që prej fillimit të gushtit në të gjitha bashkitë e vendit, propozimi i PS-së po has kundërshti nga qytetarët gjatë dëgjësave publike. Në disa bashki të vogla ka shkaktuar edhe protesta të përditshme që refuzojnë shkrirjen e njësisë së tyre vendore me një njësi më të madhe.

Sipas projektit, bashkitë Fushë-Arrëz, Klos, Rogozhinë, Dimal, Poliçan, Patos, Divjakë, Selenicë, Maliq, Këlcyrë, Memaliaj, Libohovë, Cërrik, Belsh dhe Prrrenjas humbasin statusin si njësi të pavarura të vetëqeverisjes vendore dhe bashkohen me bashkitë fqinje më të mëdha.

Konkretisht, Fushë-Arrëzi bashkohet me Pukën, Klosi me Matin, Rogozhina me Kavajën, Dimali dhe Poliçani me Beratin, Patosi me Fierin, Divjaka me Lushnjën, Selenica me Vlorën, Maliqi me Korçën, Këlcyra me Përmetin, Memaliaj me Tepelenën, Libohova me Gjirokastrën, Cërriku e Belshi me Elbasanin, ndërsa Prrrenjasi kalon nën varësi të bashkisë Librazhd.

Modeli i propozuar synon të ruajë bashkinë si qendër e organizimit vendor, por ndryshon organizimin e saj të brendshëm nga skema "Bashki-Njësi Administrative" në "Bashki-Qytet-Njësi Administrative".

Për çdo qytet parashikohet emërimi i një nënkryetari përgjegjës për koordinimin e shërbimeve, ndërsa këshillat bashkiakë do të riorganizohen për të pasqyruar peshën demografike të qyteteve përbërëse.

Nga ana tjetër opozita ka dalë me një projekt që propozon shtimin e bashkive nga 61 në 100 njësi për të decentralizuar shërbimet publike më pranë komuniteteve./ Reporter.al/

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Ministri i krimit'/ I riu: SPAK të mos e lejojë Edi Ramën të bëjë një drejtësi si pazar politik! Nesër te parlamenti



Qytetarët mbyllin fjalimet, nisin marshimin nëpër Tiranë: Rama, jepe dorëheqjen!



'Për 10 ditë Rama do ikë, fjalë burrash'/ Thirrja e nënës për të rinjtë: Mos rri në kafe, ejani këtu


kapi për qatë dhe me unë të zbuluak



Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë



'S'ka normalitet për situatën ku ndodhemi', Këlliçi: Të gjithë e kanë pranuar skandalin e Roni Yeffet, Rama jo!



'Rama, një bandit që vjedh i pashqetësuar', Blushi: 'KAYO' e rivërtetoj se shteti është mafie sot!

TË NGJASHME



Vlora Hyseni e arrestuar/ Demiraj: Duhej mbledhur Këshilli i Sigurisë Kombëtare! Në SHBA janë të skandalizuar



VIDEO-'Po kontrollohen faktet'/ Çela zbulon detaje nga dokumentari austriak për korrupsionin në Shqipëri



Berisha: Vetëm demokratët mund t'i japin goditjen përfundimtare këtij regjimi! Pa largimin e Ramës, Shqipëria vetëm do rrokulliset



'Rama jep dorëheqjen! – Nis marshimi i qytetarëve nga sheshi 'Skënderbej' drejt Kryeministritë



Berisha: Mbështetja e protestës qytetare, detyrë madhore e PD! Duhet të bëjmë çdo gjë për ripërtëritjen e partisë



VIDEO/ Berisha: Bojkoti do ishte avantazh për Ramën, ne do i japim atij përgjigjet më të forta në parlament



'Rama jep dorëheqjen'! - Shqiptarët në revoltë kundër qeverisë: Shteti ka rënë

[LAJME](#) [POLITIKË](#) [KRONIKË](#) [EKONOMI](#) [KOSOVA](#) [BOTË](#) [KULTURË](#) [SHKENCË](#) [SPORT](#) [JETË/STIL](#) [TRASHËGIMI](#) [MEDIË](#) [ARKIVA](#)



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.